



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:026873
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05591083

C.nr.61/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditëses K me seli në Prishtinë, - Distrikti Gjakovë, kundër të paditurit S.H.K nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 131,67 €, jashtë shqyrtimit me dt.18.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)

MIRATOHET në tërësi kërkesë – padia e paditëses K me seli në Prishtinë, - Distrikti Gjakovë, ashtu që të DETYROHET i padituri S.H.K nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, që në emër të kompenzimit të dëmit t’ia paguaj shumën prej 131,67 €, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 11.02.2021, e gjerë te pagesa definitive, si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej 20,00 €, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pala paditëse në padi ka theksuar se i padituri me qëllim që të i sjell vetit pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njehsorit elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këto veprime energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar.

Në bazë të provave si Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.94/2018, prej datës 27.05.2019, dhe i plotfuqishëm 09.11.2019, i padituri e ka pranuar fajësinë për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe i njëjti është dënuar me kusht.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” me dt. 18.11.2021, i ka dërguar të paditurit padinë dhe Aktvendimin për dhënien e përgjegjës në padi.

Duke e bërë shikimin në flete dërgesën për dorëzim personal konstatohet se i padituri i lartpërmendur e ka pranuar personalisht Aktvendimin C.nr.61/21 të dt. 18.11.2021, padinë dhe provat me dt.25.11.2021, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjegjës në

padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK-së, të larte cituar Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijnë:

a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi,

b) Themelësia e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe

c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u vendos komfor nenit 452.1 të LPK, me ç ‘rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksave gjyqësore shumë prej 20,00 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr.61/2021, më 18.04.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.